



Prishtinë, 30 tetor 2009
Kodi i ZRRE-së: V_207_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në nenin 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Ligjit për Energjinë nr. 2004/8;
3. Bashkërendimin e të Ardhurave të lejuara me ato të realizuara për sezonin e ngrohjes 2008/2009, të Ngrohtores së Qytetit (NQ) Termokos SH.A.
4. Paqëndrueshmërinë e çmimit të importit të lëndës djegëse – mazutit, si pasojë e lëvizjeve të çmimit të naftës në bursat ndërkombëtare, i cili çmim ndikon dukshëm në koston totale të afarizmit të ndërmarrjes; dhe
5. Qëllimin që të sigurohet stabilitet i tarifave të ngrohjes qendrore, që do të reflektojnë koston reale dhe të arsyeshme të prodhimit dhe furnizimit me ngrohje qendrore.

Në mbledhjen e mbajtur me datë 30 tetor 2009, nxori këtë:

VENDIM

1. **APROVOHEN** tarifat për NQ Termokos SH.A. për sezonin e ngrohjes 2009/2010, siç janë paraqitur në tabelat "A" dhe "B".

TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT TERMOKOS SH.A PËR SEZONIN E NGROHJES 2009/2010
--

Tabela A . TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE
--

NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A.		
Komponentet e Tarifave	Konsumatorët shtëpiakë	Konsumatorët Komerเชียลë e Institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.06 [€/m ² për muaj]	0.08 [€/m ² për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	0.78 [€/m ² për muaj]	0.92 [€/m ² për muaj]

Tabela B . TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE
--

NDËRMARRJAE NGROHJES QENDRORE TERMOKOS SH.A	
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes (komponenta fikse)	0.59 [€/kW për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	45.50 [€/MWh]



2. Tarifat e aprovuara do të publikohen nga NQ Termokos SH.A. në një të gazetave ditore me qarkullim më të gjerë në Kosovë, brenda pesë ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të vendimit nga ZRRE-ja në faqen elektronike zyrtare të saj.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të përdorë të drejtat sipas ligjit, auditore regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e tyre, me qëllim për të verifikuar të dhënat e paraqitura nga NQ Gjakova SH.A të nevojshme për bashkërendim dhe përcaktim të tarifave.
4. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e juridiksionit përkatës brenda 14 ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, cilado të ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar